STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 16 janar 2013

**DEKLARATE NGA GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) PER TE FALENDERUAR DELEGACIONIN NE KONGRES TE NJU JORKUT (NEW YORK) PER PERPJEKJET NE MIRATIMIN E NDIHMES PER SENDIN (SANDY)**

"Votimi në Dhomën e Përfaqësuesve për të miratuar ndihmën federale për shtetet e prekura nga Uragani Sendi (Sandy) është një ndihmë e mirëpritur për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) dhe të gjithë pronarët e shtëpive, bizneseve dhe komuniteteve që u prekën nga stuhia.

Dëshiroj të falënderoj personalisht të gjithë delegacionin në Kongres të Shtetit të Nju Jorkut (New York State). Që nga dita kur Sendi (Sandy) preku në tokë, anëtarët e delegacionit të Nju Jorkut (New York) kanë qënë në vijën e parë duke luftuar për komunitetet e shkatërruara nga stuhia dhe duke vendosur nevojat e shtetit tonë përpara politikës. Do të dëshiroj të falënderoj Senatorët tanë Çak Shumër (Chuck Schumer) dhe Kërstin Xhilibrend (Kirsten Gillibrand) për të gjithë punën e tyre të madhe në Senat dhe për përpjekjet e pandërprera për të mbledhur mbështetje për këtë ndihmë. Gjithashtu dëshiroj të falënderoj veçanërisht Përfaqësuesit Pitër King (Peter King), Çarls Rengël (Charles Rangel), Nito Loui (Nita Lowey), Gregori Miks (Gregory Meeks) dhe Majkëll Grim (Michael Grimm) për udhëheqjen e tyre dhe për punën e palodhur së bashku me udhëheqjen republikane të Dhomës së Përfaqësuesve për të siguruar se ky ligj u paraqit dhe u miratua.

Në emër të të gjithë banorëve të Nju Jorkut, falënderoj të gjithë delegacionin për bashkëpunimin e tyre në sigurimin e këtij financimi mjaft të nevojshëm dhe mezi pres që Senati t'a miratojë ligjin javën e ardhshme, në mënyrë që banorët e Nju Jorkut të mund të kenë ndihmën mjaft të nevojshme që presin dhe që meritojnë."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian